

FORMULAR STANDARDE LIDHUR ME KRITERET E PËRJASHTIMIT

I NDËRMARRJES APLIKUESE PËR FONDIN SHQIPTARË TË KONKURRUESHMËRISË.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisve të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, sipas interpretimit të këtij termi në ligjet përkatëse, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie.

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9367.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të ndërmarrjes _____

a. deklaroj nën përgjegjësinë time personale dhe të ndërmarrjes që përfaqësoj se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj. Marr përsipër të informojë Komisionin pa vonesë për çdo ndryshim në këtë situatë pas datës së paraqitjes së propozimit.

- b. Deklaroj nën përgjegjësinë time personale dhe të ndërmarrjes që përfaqësoj se ndërmarrja:
1. nuk është e falimentuar ose e likuiduar, nuk ka çështje të saj që administrohet nga gjykatat, nuk ka bërë marrëveshje me kreditorët, nuk ka pezulluar aktivitetet e biznesit, nuk është *palë* e një gjykimi apo vendimi në lidhje me çështjet e mësipërme dhe nuk është në asnjë situatë të ngjashme që rrjedh nga një procedurë e ngjashme e parashikuar në legjislacionin kombëtar apo rregullore;
 2. i ka plotësuar detyrimet e saj lidhur me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore me pagimin e tatimeve në përputhje me dispozitat ligjore të Shqipërisë, si dhe me ato të vendit apo shtete të tjera në të cilat ajo ka një seli ligjore;
 3. nuk ka qenë subjekt i një gjykimi që ka fuqinë e gjësë së gjykuar për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, ose ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm në dëm të interesave financiare të shtetit shqiptar.

Përveç kësaj, deklaroj në emër tim se :

- a. nuk jam dënuar me vendim të formës së prerë për një vepër penale në lidhje me sjelljen profesionale;
- b. nuk kam qenë fajtor për sjellje të rënda profesionale;
- c. nuk kam qenë subjekt i një gjykimi që ka fuqinë e gjësë së gjykuar për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, ose ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm në dëm të interesave financiare të shtetit shqiptar.

Duke nënshkruar këtë formular, nënshkruesi pranon se ai ka qenë i njohur me ndëshkimet e aplikueshme administrative dhe financiare, të cilat mund të zbatohen nëse lind njëra nga situatat e përshkruara në këtë formular dhe që informacioni i dhënë për AIDA-n brenda kontekstit të këtij aplikimi është i saktë, i sinqertë dhe i plotë.

Emri i plotë i ndërmarrjes aplikuese	
Nënshkruan në emër të ndërmarrjes Emri dhe Mbiemri Administrator/personi i autorizuar:	Vula
Data:	